

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
Nr. 93 Rep. Nr. 50 Kol.



### KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 25/01/2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), përpara meje Noteres Sofika K. Braka, me zyrë në rrugën "Ismail Qemali", pallati 11/1, u paraqitën personalisht palët e poshtëshënuara për lidhjen e kësaj kontrate shitblerjeje kuotash të kapitalit të shoqërisë:

**SHITËSIT: Z. Giuseppe Genise**, shtetas italian, i datëlindjes 16.05.1986, lindur dhe banues ne Itali, mbajtës i Carta D'Identita nr. AS9407469, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut të shoqërisë "**Studio Genise**" Sh.p.k., themeluar si person juridik në datën 25.09.2018, me NUIS: L82201026E;

**dhe**

**Z. Giovanni Genise**, shtetas italian, i datëlindjes 21.03.1948, lindur dhe banues ne Itali, mbajtës i Carta D'Identita nr. AV 8550903, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut të shoqërisë "**Studio Genise**" Sh.p.k., themeluar si person juridik në datën 25.09.2018, me NUIS: L82201026E;

**BLERËSI: z. Giancarmine Battigaglia**, shtetas italian, i datëlindjes 26.09.1977, lindur ne Crotone, Itali e banues ne Tirane, identifikuar me pasaporten Italiane me nr. AA28275522, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

#### NENI 1

Shitësi Z. **Giuseppe Genise**, është ortak dhe zotërues te 1 kuote, me pjesëmarrje 50% të kuotave, të shoqërisë "**Studio Genise**" Sh.p.k., themeluar si person juridik në datën 25.09.2018, me NUIS: L82201026E, me seli në Rruga "Ismail Qemali", nd. 14, hyrja 4, apartamenti 5, Tiranë.

Gjithashtu, Shitësi Z. **Giovanni Genise**, është ortak dhe zotërues te 1 kuote, me pjesëmarrje 50% të kuotave, të shoqërisë "**Studio Genise**" Sh.p.k., themeluar si person juridik në datën 25.09.2018, me NUIS: L82201026E, me seli në Rruga "Ismail Qemali", nd. 14, hyrja 4, apartamenti 5, Tiranë.

1.1 Nga këto kuota të kapitalit themeltar të shoqërisë "**Studio Genise**" Sh.p.k. që ata zotërojnë, Shitësit i shesin Blerësit 50% kuotave te kapitalit, pra Z. **Giuseppe Genise shet 25%** te kuotave te kapitalit që ai zoteron dhe z. **Giovanni Genise shet 25%** te te kuotave te kapitalit që ai zoteron, me vlerën e tyre, i cili pranon t'i blejë ato, sipas kushteve dhe proporcionit të përcaktuar më poshtë në këtë kontratë.

## NENI 2

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotave në pronësi të Shitësit, të cilat përfaqësojnë 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë “**Studio Genise**” Sh.p.k., është në vlerën e tyre nominale.
- 2.2 Ky çmim është likuiduar nga Blerësi kundrejt Shitësve, dhe Shitësit deklarojnë se e kanë marrë këtë çmim dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me pagesën e tyre ndaj Blerësit.

## NENI 3

- 3.1 Blerësi, i blen kuotat që shesin Shitësit, në raportin e mëposhtëm:

**Giancarmine Battigaglia**, blen 50% të kuotave, kundrejt çmimit të tyre nominal prej 50 Leke, dhe bëhet ortak me 50 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë “**Studio Genise**” Sh.p.k.

3.2 Me realizimin e kësaj shitblerje të 50% të kuotave të shoqërisë “**Studio Genise**” Sh.p.k., Blerësit i transferohen proporcionalisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja e tyre dhe Shoqëria “**Studio Genise**” Sh.p.k. perbehet nga ortakët me përqindjet perkatëse:

**Giuseppe Genise**, zoteron 25% te kuotave te kapitalit te shoqërisa “**Studio Genise**” Sh.p.k.;

**Giovanni Genise**, zoteron 25% te kuotave te kapitalit te shoqërisa “**Studio Genise**” Sh.p.k.;

**Giancarmine Battigaglia**, zoteron 50% te kuotave te kapitalit te shoqërisa “**Studio Genise**” Sh.p.k.;

## NENI 4

4.1 Shitësit deklarojnë se janë pronar me të drejta të plota mbi kuotat që i transferon Blerësit; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e tyre apo që t'i kenë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi to deri në datën e sotme; ata i shesin këto kuota të kapitalit të shoqërisë Blerësit të lira nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi to, nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloji natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi to.

## NENI 5

5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.

5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në



zgjdhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata hartohet në 4 (katër) kopje me nga tre fletë, me të njëjtën vlerë ligjore. Une noterja, pasi iu bëra me dijeni palëve, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për këtë kontratë shitblerjeje të kuotave që realizojnë, u lexova palëve Kontratën me zë të lartë e të qartë. Kontrata u lexua prej vetë atyre dhe, palët pasi deklarojnë se e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë në praninë time. Unë noterja e legalizoj sipas ligjit.

Z. Giuseppe Genise, Z. Giovanni Genise dhe Z. Giancarmine Battigaglia, shtetas italian, morën dijeni për përmbajtjen e kësaj Kontrate nga përkthimi i bërë në gjuhën Italiane nga z. Denis Kuçi.

*Denis Kuçi*  
PALET KONTRAKTORE

SHITËSI

GIUSEPPE GENISE

*Giuseppe Genise*

BLERËSI

GIANCARMINE BATTIGAGLIA

*Giancarmine Battigaglia*

GIOVANNI GENISE

*Giovanni Genise*

NOTERE  
Sofika K. BRAKA

*Sofika K. BraKa*  
Taksa e Publike u Pagua  
NOTER  
TIRANE



Shoqëria "Studio Genise" Sh.p.k.  
Rruga "Ismail Qemali", Ndertesha 14, Hyrja 4, Apartamenti 5  
Tiranë  
NUIIS: L 82201026 E



**VENDIM**  
**I**  
**ASAMBLESE SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË**

**datë 25.01.2019**

Sot më datë 25.01.2019, asambleja e ortakëve të shoqërisë "Studio Genise" Sh.p.k., e perbere nga ortaku Z. Giuseppe Genise qe zotëron 50% te kuotave te shoqerise, dhe z. Giovanni Genise qe zotëron 50% te kuotave te shoqerise, pasi moren në shqyrtim ecurinë e deritanishme dhe nevojat e shoqërisë, bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në ato të Statutit të shoqërisë,

**VENDOSI:**

Miratimin e shitjes, kundrejt vlerës së tyre nominale të 50% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "Studio Genise" Sh.p.k., të zotëruara nga ortakët Z. Giuseppe Genise dhe z. Giovanni Genise, tek Blerësit, z. **Giancarmine Battigaglia**, shtetas italian, i datëlindjes 26.09.1977, lindur ne Crotone e banues ne Tirane, identifikuar me pasaporten Italiane me nr. AA28275522, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

1. Miratimin e shitjes, kundrejt vlerës së tyre nominale të 50% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "Studio Genise" Sh.p.k., të zotëruara nga ortakët Z. Giuseppe Genise dhe z. Giovanni Genise tek Blerësi, dhe z. **Giancarmine Battigaglia**, shtetas italian, i datëlindjes 26.09.1977, lindur ne Crotone e banues ne Tirane, identifikuar me pasaporten Italiane me nr. AA28275522, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Zotërimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë bëhet si më poshtë:  
*"Kuotat e Shoqërisë zotërohen, nga ortakët e saj, si më poshtë:*  
*-Giancarmine Battigaglia zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë 50% (pesedhjetë).*  
*-Giovanni Genise zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë 25% (njëzetë e pesë).*  
*-Giuseppe Genise zotëron 1 (një) kuotë, me vlerë 25% (njëzetë e pesë).*
3. Depozitimimin e këtij Vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

Ortakët z. **Giovanni Genise** dhe **Z. Giuseppe Genise**, shtetas italian, morën dijeni për përmbajtjen e këtij Vendimi nga përkthimi i bërë në gjuhën Italiane nga z. Denis Kuçi.

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË**  
**"Studio Genise" SH.P.K.**

**GIOVANNI GENISE**

*Giovanni Genise*  
*GG*

**GIUSEPPE GENISE**

*Giuseppe Genise*  
*GG*

*Denis Kuçi*